

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, zyrtaren ligjore Sanije Troshupa, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehures F.O ga V, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.279/2016, dt.06.06.2016, dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë **15/03/2017**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.279/2016, dt.06.06.2016, kjo Gjykatë i jep këtë;

URDHËR NDËSHKIMOR

E pandehura:

F.O, nga i ati Sh, e lindur me datën *data e lindjes*, në V, ku edhe tani jeton në rrugën "...", me numër personal *numer personal*, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE: Me dt.29/12/2014, rreth orës 09:00, në Prishtinë, në rrugën "...", e pandehura duke drejtuar automjetin e tipit "O C", ngjyrë e hiri, me targa ..-...-..., nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 54 dhe 126 të LSKRR, ka rrezikuar trafikun publik dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk e ka mbajtur distancën e mjaftueshme të sigurisë me automjetin para saj, ku me pjesën e përparme ka goditur mbrapa automjetin e tipit "F F", ngjyrë e bardhë, me targa ..-...-..., të cilën e drejtonte tani i dëmtuari B.R, me ç 'rast nga ky aksident kanë marrë lëndime të lehta trupore, të dëmtuarit B.R dhe M.D.

- **Më këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.**

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 42, 43, 46,73 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 dhe nenit 495 të KPPRK-së, të pandehures i :

S H Q I P T O N

DËNIM MË GJOBË në shumë prej 200.00 € (dyqind euro), të cilin dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse e pandehura nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 46 të KPRK-së, deri në zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg shumë prej 20 (njëzetë) €.

E pandehura obligohet që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumen prej 40.88€, për ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 20.00€, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Palët e dëmtuara B.R nga P, rruga "...", nr../., si dhe M.D nga P, rruga "...", Kompleksi ... lex, hyrja ., nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civilo – juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.279/2016, dt.06.06.2016, po ashtu me të njëjtën datë është parashtruar edhe kërkesa për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, kundër të pandehures F.O, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar në bazë të nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e të pandehures se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas Aktakuzës së Prokurorit të Shtetit.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehures, se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohet nga provat si vijojnë dhe atë: nga raporti i aksidentit me numër të rastit 2014-AR-2966, dt.29/12/2014, raportet mjekësore në emër të dëmtuarve, ekspertiza mjeko-ligjore e ekspertit mjeko-ligjor Dr.V.K, e datës 28/03/2016, ku lëndimet janë kualifikuar dëmtime të natyrës se lehtë trupore, mendim dhe konstatim i ekspertit të komunikacionit rrugor ing. R.B e datës 25/03/2015, që konstaton lëshimet e të pandehures, si dhe prova tjera nga shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë veprimet në kuptim të veprës penale me të cilën akuzohet i pandehuri.

Sipas KPRK-së, për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, dënimi për këtë vepër penale është se kryerësi dënohet me dënim me gjobë apo burgim deri në një (1) vit.

Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-se, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoj rrethanat në matjen e dënimit, duke vlerësuar se një dënim i tillë është adekuat dhe është i përballueshëm në raport me gjendjen e saj ekonomike dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 të KPRK-ës dhe se e pandehura do të përmbahet dhe do të ketë sidomos kujdes të shtuar në trafikun publik, në mënyrë që të mos rrezikohet jeta, shëndeti dhe pasuria materiale e personave në trafikun publik.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori konform nenit 450 të KPP-ës.

Në mbështetje të nenit 463 të KPP-së, palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontestin civilo - juridik.

Nga theksimet e theksuara si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.2599/2016 dt.15/03/2017

Zyrtarja ligjore
Sanije Troshupa

Gjyqtari
Rrustem Begolli

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi pala ka të drejtë kundërshtimi, në afat prej 8(tetë) ditësh, nga dita e pranimit, kundërshtimi i parashtrohet kësaj gjykate.